



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DREJTORIA E METODOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT

PROGRAM TRAJNIMI

Muaji Mars 2021

Referuar Plan-Veprimit mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Audituesve të KLSH-së” për vitin 2021, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 14 datë 08.02.2021, gjatë muajit Mars 2021, është zhvilluar trajnimi i si më poshtë, në të cilin kanë marrë **pjesë 11 auditues, të rinj dhe sapo rektutuar.**

- **Fokusi i trajnimit:** “Mbi standardet e auditimit dhe kornizën ligjore të KLSH-së”
- **Target grupi:** Kategoria e parë e audituesve, të cilët duhet të realizojnë 25 ditë trajnimi në vit, konkretisht:
 - Audituesit e rinj me eksperiencë, deri në një vit;
 - Audituesit e sapo rekrutuar.
- **Kalendari i realizimit të trajnimeve:**
 - Nga data 1-2 Mars, përgatitja e Programit të trajnimeve;
 - Nga data 5-15 Mars, përgatitja e temave nga trajnuesit;
 - Nga data 18-24 Mars, zhvillimi i trajnimeve.
- **Kohëzgjatja e trajnimit:** Trajnimi do të zgjasë 2 orë, dhe do të shtrihet në 5 ditë, nga një temë në ditë sipas skedulimit të mëposhtëm.

Për kategorinë e parë, audituesit e sapo rekrutuar dhe me eksperiencë deri në 1 vit në KLSH, është e nevojshme që paketa e trajnimit të përfshijë njohuritë themelore të nevojshme në fusha si më poshtë vijon:

Njohuri për kuadrin ligjor kushtetues dhe legjislacionin themeltar të auditimit publik, (ligji organik, rregullorja e procedurave të auditimit, udhëzuesit, standardet profesionale ndërkombëtare dhe praktikat më mira);

Aktet më të rëndësishme të Kornizës INTOSAI-t: Deklarata e Limës, Deklarata e Meksikos, Deklarata e Uruguait, etj.

Praktikat e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë (manualet e përditësuara, qershor 2020) për një ekzaminim sistematik të të dhënave financiare ose të kontabilitetit, për të verifikuar saktësinë, vërtetësinë ose pajtueshmërinë e tyre me kornizën legjislative, si dhe përputhshmërinë e aktivitetit të njësive publike me kornizën ligjore respektive;

Auditimet e performancës dhe të IT-së, si dukuri tipike të sektorit privat, të shtrira me sukses në auditimin e sektorit publik.

Kalendari i trajnimit

Nga data 18-24	Temat	Trajnuesit
18.03.2021	<ul style="list-style-type: none">- Kushtetuta e RSH, neni 162-165- Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”	Koço Sokoli Kryeauditues Departamenti Juridik

	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionit të KLSH-së 	<p>Edukimi: Drejtësi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Licencë me titull “Avokat”, viti 2006; - Certifikuar si Auditues i Brendshëm, MFE, Njësia e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm; - Certifikuar në fushën e Prokurimit publik me mjete elektronike, APP.
19.03.2021	<p>Njohuri të përgjithshme mbi aktet më të rëndësishme të Kornizës INTOSAI-t. Nivelin e parë “Parimet INTOSAI”</p> <ul style="list-style-type: none"> - ISSAI P-1 “Deklarata e Limës” - ISSAI P-10 “Deklarata e Meksikos” - ISSAI P-12. - ISSAI 130 “Kodi i etikës” - ISSAI 140 “Sigurimi i Cilësisë” 	<p>Xhuljeta Çela Audituese e Lartë, Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore</p> <p>Edukimi: Marrëdhënie Ndërkombëtare, Itali</p> <ul style="list-style-type: none"> - Master marrëdhënie ndërkombëtare, Fakulteti i shkencave politike, “Cesare Alfieri”, Universiteti i Firences, Itali; - Certifikuar nga GAO, USA, Washington DC, në “International Auditor Fellowship”.
22.03.2021	<p>Njohuri mbi Standardet e Auditimit, Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ISSAI 100 - ISSAI 200 - ISSAI 300 - ISSAI 400 	<p>Ermira Vojka Pozicioni: Audituese e Lartë Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.</p> <p>Edukimi: Inxhinieri Agrare/Financë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Certifikuar në ndjekjen e intershipit pranë Gjykatës Europiane të Audituesve, ECA, Luksenburg; - Certifikuar nga GAO, USA, Washington DC, në “International Auditor Fellowship”.
24.03.2021	<p>Njohuri mbi Standardet e Auditimit, niveli i III-të dhe i IV-t (Manualet, udhëzuesit dhe praktikant më të mira) mbi të cilat mbështetet veprimtaria audituese në KLSH</p> <p>ISSAI 2000 ISSAI 3000 ISSAI 4000, etj.</p>	<p>Miranda Berdo Pozicioni: Audituese e Parë, Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore</p> <p>Edukimi: Financë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Master shkencor në Ekonomi dhe Menaxhim, Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë”; - Certifikuar në programin e auditimit të Deloitte & Touche “Menaxhimi i sistemeve të auditimit”, Torino Itali. - Certifikuar në ndjekjen e intershipit pranë Gjykatës Europiane të Audituesve, ECA, Luksenburg;
25.03.2021	Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH.	<p>Brunilda Zeneli Drejtoreshë, Drejtoresha e Metodologjisë dhe Zhvillimit.</p> <p>Diploma: Financë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Master në Administrim Biznes; UJP “S & P Qirjazi”;

		<ul style="list-style-type: none"> - Certifikatë “Kontabël i miratuar në sektorin publik” CIPFA-CEF - Certifikatë Auditues i Brendshëm, në sektorin publik Ministria e Financave; - Certifikatë “Vlerësues i pasurive të paluajtshme”, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit; - Certifikuar mbi “Menaxhimin e prokurimeve të punëve publike” nga ILO, Itali.
--	--	--

Elementët e trajnimit:

- **Skedulimi**
- **Zhvillimi**
- **Kontrolli**
- **Vlerësimi**

Që të realizohet një proces trajnimi optimal, duhet të plotësojmë disa kushte:

- Sigurimi i teknikës së nevojshme: Trajnimi do të zhvillohet online, nëpërmjet Platformës “Microsoft Skype”. Trajnerët para orës së trajnimit duhet të dërgojnë me email, të gjithë audituesve të përcaktuar për të ndjekur trajnimin, linkun ku do të aksesojnë;
- Sigurimi i materialeve të nevojshme: Të gjithë audituesit, kanë akses të plotë mbi materialet të cilat do të jenë objekt i këtij trajnimi. Standardet, rregulloret, udhëzues, ligji organik i KLSH-së etj., janë të publikuara në faqen web të KLSH-së.
- Sigurimi i trajnerëve të aftë: Nga lista e trajnerëve janë përzgjedhur trajnerë, të cilët kanë kompetencën e duhur profesionale në drejtimet përkatëse të trajnimit.

Skedulimi i programit: Skedulimi i programit është bërë duke patur në konsideratë ngarkesën në punë të audituesve, Zhvillimi online është një lehtësi, pasi ndjekja e trajnimit mund të kryhet nga vendet e punës, pa prezencë fizike. Është shtrirë në 5 ditë, me fokus bazën ligjore dhe standardet e auditimit, njohuri të përgjithshme. Trajnimi do të jetë dy orë në ditë, duke mos cenuar veprimtarinë audituese të gjithsecilit.

Zhvillimi i trajnimit: Zhvillimi i trajnimit, është konkretizimi i të gjitha etapave të mëparshme të procesit të trajnimit si; përcaktimi i nevojave, planifikim-programimi dhe skedulimi.

Në etapën e zhvillimit të trajnimit ndikojnë disa faktorë:

- Përzgjedhja e platformave të ndryshme online;
- Përgatitja e lektorëve, sa ata e bëjnë tërheqës trajnimin;
- Përgatitja dhe interesi i pjesëmarrësve, sa ata kanë interes rreth çështjeve që trajtohen, kjo është e lidhur ngushtë me etapën e parë të këtij procesi me përcaktimin e nevojave dhe sa janë të përgatitur pjesëmarrësit.

Kontrolli: Gjatë procesit të zhvillimit të trajnimit është e rëndësishme që në mënyrë permanente të ndiqet sa është realizuar dhe si janë realizuar objektivat që janë programuar për t’u realizuar. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet disa mënyrave:

- Testimi i reagimit të pjesëmarrësve gjatë zhvillimit të trajnimit, kjo nuk teston njohuritë e tyre, por mund të vlerësojë pozitivisht interesin e tyre, për çështje të veçanta dhe vlerësimin për trajnerë të veçantë;
- Testimi i njohurive, në fund të zhvillimit të seanceve për çështje të caktuara;
- Shembuj konkretë duke punuar në grupe të vogla, vlerësimi i tyre;
- Debateve dhe konkluzioneve në fund të çdo seance, etj.

Vlerësimi i trajnimit: Vlerësimi i trajnimit është etapë me rëndësi, pasi mbledh të dhënat e nevojshme për të përcaktuar nëse procesi i trajnimit ishte i efektshëm.

Vlerësimi i programi i trajnimit: *(Plotësimi i pyetësorit të përgatitur nga trajnuesit, nga ana e audituesve, pjesëmarrës në trajnim)*

- Për të përcaktuar nëse trajnimi ka kontribuar në arritjen e qëllimeve të auditimit;
- Për të vlerësuar si dhe sa, të trajnuarit perfeksionuan njohuritë e tyre në këtë proces trajnimi;
- Për të vlerësuar metodat e përdorura në trajnim, nëse ato e ndihmuan të trajnuarin në arritjen e objektivave të trajnimit.
- Për të dizajnuar sa më mirë trajnimin e ardhshëm duke vlerësuar se ku ishin të metat dhe dobësitë e trajnimit të kryer.
- Për ta bërë në këtë mënyrë trajnimin një mjet sa më efikas
- Për të justifikuar koston e trajnimit, pasi KLSH investon në mënyrë që të përfitohen avantazhet e programuara.

Drejtores

Brunilda Zeneli